



Law Journal

REFORMA NË DREJTËSI | SHKURT 2018

**ECURIA E KRIJIMIT TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR
(K.L.Gj)**

ECURIA E KRIJIMIT TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR (K.L.Gj)

I. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi që, sipas nenit 147 të Kushtetutës së Ndryshuar, do të garantojë pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Shqipëri. Neni 147/a i Kushtetutës së ndryshuar, cakton funksionet e rëndësishme që KLGj-ja do të ushtrojë mbi gjyqësorin shqiptar:

- i. Emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë dhe transferimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
- ii. Vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
- iii. Propozimin e kandidatëve për Gjyqtarë të Gjykatës së Lartë;
- iv. Miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave të etikës gjyqësore;
- v. Drejtimin e administratës gjyqësore;
- vi. Propozimin dhe administrimin e buxhetit të gjykatave;

KL Gj-ja është një organ kolegjal i cili përbëhet nga 11 anëtarë. Përkatësia profesionale dhe procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të KLGj-së është e ndryshme.

Shumica e thjeshtë e anëtarëve të KLGj-së (**6 anëtarë**) zgjidhet nga radhët e gjyqësorit: (i) 3 gjyqtarë nga gjykatat e shkallës së parë ; (ii) 2 gjyqtarë nga gjykatat e Apelit; (iii) 1 gjyqtar nga Gjykata e Lartë. Anëtarët e gjyqësorit zgjidhen nga **Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve** sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Ligji Nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*” (“Ligji 115/2016”). Pakica e anëtarëve të KLGj-së (**5 anëtarë**) zgjidhen nga radhët e juristëve jashtëgjyqësorit: (i) 2 anëtarë nga radhët e avokatëve; (ii) 2 anëtar nga pedagogët e fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës; (iii) 1 anëtar nga shoqëria civile. Kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve jo gjyqtarë janë të përcaktuara në nenin 147 të Kushtetutës së ndryshuar dhe Ligjin 115/2016. Miratimin përfundimtar të anëtarëve të KLGj-së nga radhët e juristëve e kryen **Parlamenti i Republikës së Shqipërisë**.

Për shkak të rëndësisë së këtij organi për funksionimin e reformës në drejtësi, Neni 179 i Kushtetutës së ndryshuar dhe ligji Nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*” kanë përcaktuar që KLGj-ja duhet të krijohet **jo më vonë se 8 muaj** pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve Kushtetuese¹. Ndryshimet Kushtetuese kanë hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare Nr. 138 të vitit 2016, dhe përkatësisht në datën 11 Gusht 2016. Megjithatë që nga hyrja në fuqi e ndryshimeve Kushtetuese ka kaluar një periudhë përafërsisht prej 1 viti e gjysmë, institucioni i KLGj-së nuk është krijuar ende.

Tabela e mëposhtme jep përditësimet e në lidhje me ngritjen e KLGj-së. Tabela do të përditësohet periodikisht, deri në krijimin përfundimtar të KLGj-së.

¹ Neni 179 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Neni 277 (1), Ligji Nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”.

II. Tabela – Ngritja e KLGJ-së

DATA	ANËTARË GJYQTARË	ANËTARË JURISTË (AVOKAT, PEDAGOG, SHOQËRI CIVILE)
25 Janar 2017	Gjykata e Lartë shpalli zyrtarisht listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore për t'u zgjedhur anëtarë të KLGj-së nga Gjykata e Lartë ² ; Gjykatat e Apeleve ³ ; Gjykatat e Rretheve Gjyqësore ⁴	/
22 Janar 2018	Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve e cila do të zgjedhë 6 anëtarët nga gjyqësori nuk është mbledhur dhe nuk ka një datë se kur do të mblidhet.	<p>Mbledhja Nr. 1 e Nën/komisionit Parlamentar për përzgjedhjen e anëtarëve të KLGj-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Votimi: asnjë kandidat nuk merr numrin minimal prej 4 votash • Shorti: hidhet shorti dhe krijohet lista e kandidatëve e zgjedhur me short. • Miratim: Miratohet lista përfundimtare e zgjedhur me short dhe i përcillet Kuvendit për votim në Seancë Plenare
25 Janar 2018	Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve e cila do të zgjedhë 6 anëtarët nga gjyqësori nuk është mbledhur dhe nuk ka një datë se kur do të mblidhet.	<p>Votimi i Parë i Kuvendit: me Vendimin Nr. 3/2018 datë 25.1.2018, Kuvendi i Shqipërisë vendosi rrëzimin e listës në bllok të anëtarëve të KLGj-së që rezultoi nga shorti i Mbledhjes Nr. 1 të Komisionit Parlamentar, sepse nuk u arrit shumica prej 2/3.</p>
29 Janar 2018	Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve e cila do të zgjedhë 6 anëtarët nga gjyqësori nuk është mbledhur dhe nuk ka një datë se kur do të mblidhet.	<p>Mbledhja Nr. 2 e Nën/komisionit Parlamentar për përzgjedhjen e anëtarëve të KLGj-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Votimi: asnjë kandidat nuk merr numrin minimal prej 4 votash • Shorti: hidhet shorti dhe krijohet lista e kandidatëve e zgjedhur me short. • Miratim: Miratohet lista përfundimtare e zgjedhur me short dhe i përcillet Kuvendit për votim në Seancë Plenare

² Artan Zeneli dhe Medi Bici.

³ Ilir Toska – Gjykata e Apelit Tiranë; Nertina Kosova – Gjykata e Apelit për Krime të Rënda; Besim Trezhnjeva – Gjykata e Apelit Durrës.

⁴ Alma Brati - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Artan Laze - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Astrit Faqolli - Gjykata e Rrethit Tiranë; Bledar Abdullahi - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Brunilda Kadi - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Brunilda Kasmi - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Dritan Hallunaj – Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda; Manjola Xhaxho – Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Marçela Shehu - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

DATA

ANËTARË GJYQTARË

ANËTARË JURISTË
(AVOKAT, PEDAGOG, SHOQËRI CIVILE)**1 Shkurt 2018**

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve e cila do të zgjedhë 6 anëtarët nga gjyqësori **nuk është mbledhur** dhe nuk ka një datë se kur do të mblidhet.

Votimi i Dytë i Kuvendit: Me Vendimin Nr. 11/2018 datë 01.02.2018, Kuvendi i Shqipërisë vendosi rrezimin e listës në bllok të anëtarëve të KLGj-së që rezultoi nga shorti i Mbledhjes Nr. 2 të Komisionit Parlamentar, sepse nuk u arrit shumica prej 2/3.

5 Shkurt 2018

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve e cila do të zgjedhë 6 anëtarët nga gjyqësori **nuk është mbledhur** dhe nuk ka një datë se kur do të mblidhet.

Mbledhja Nr. 3 e Nën/komisionit Parlamentar për përzgjedhjen e anëtarëve të KLGj-së:

- **Votimi:** asnjë kandidat nuk merr numrin minimal prej 4 votash
- **Shorti:** hidhet shorti dhe krijohet lista e kandidatëve e zgjedhur me short.
- **Miratim:** Miratohet lista përfundimtare e zgjedhur me short dhe i përcillet Kuvendit për votim në Seancë Plenare

8 Shkurt 2018

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve e cila do të zgjedhë 6 anëtarët nga gjyqësori **nuk është mbledhur** dhe nuk ka një datë se kur do të mblidhet.

Votimi i Tretë i Kuvendit: edhe në votimin e tretë të datës 8 Shkurt 2018 Kuvendi i Shqipërisë nuk e arriti shumicën prej 2/3. Si rrjedhojë e parashikimit të nenit 147 (8) të Kushtetutës së ndryshuar, lista e tretë që rezultoi nga shorti i Mbledhjes Nr. 3 të Nën/komisionit Parlamentar u konsiderua automatikisht e miratuar. 5 Anëtarët e KLGj-së janë:

- **Avokatia:** Fatmira Luli dhe Alban Toro
- **Pedagogët:** Erjon Muharremaj dhe Maksim Qoku
- **Shoqëria Civile:** Naureda Llagami